



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 874/2 Prot.

Tiranë, më 17.06. 2026

V E N D I M

Nr. 171, Datë 17.06. 2026

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*"¹, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi², mori në shqyrtim ankesën nr.112 Regj., datë 30.04.2026, të paraqitur nga znj. I.B kundër Universitetit "Eqerem Çabej", Gjirokastër, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të "*gjinisë*", "*gjendjes familjare*" dhe në kuadër të "*çdo shkak tjetër*"³.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, rezulton se pala ankuese I.B, është pedagoge me titull "Profesor i asociuar" pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

Ankuesja pretendon se ka qenë viktimë e diskriminimit në formën e hakmarrjes nga ana e punëdhënësit të saj, pas ndërmarrjes së veprimeve ligjore për mbrojtjen e të drejtave të saj.

Ankuesja parashtron se, në zgjedhjet universitare të datës 21.06.2024 kandidoi dhe fitoi pozicionin e Drejtueses së Njesisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit, Fakultetin Ekonomik, duke u emëruar zyrtarisht me urdhërin nr. 12, datë 02.09.2024, të Dekanit të Fakultetit Ekonomik. Këtë detyrë ankuesja e ushtroi deri kur me urdhërin nr. 168, datë 05.11.2025, të Rektorit të Universitetit, u shkarkua me pretekstin e sjelljes së papërshtatshme dhe shkeljes së rregullave të etikës, bazuar

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

³ Shkaku i diskriminimit i pretenduar nga ankuesja në kuadër të "*çdo shkak tjetër*" është: "*hakmarrja për shkak të ankesës që ankuesja ka bërë në Ministrinë e Arsimit dhe padia e paraqitur në gjykatë*"

në propozimin e bërë nga Dekani i Fakultetit Ekonomik me shkresën nr. 167 prot., datë 22.10.2025.

Ankuesja pretendon se shkarkimi është i pabazuar në fakte dhe se procesi është zhvilluar në shkelje flagrante të procedurës ligjore të parashikuar nga ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statuti dhe Rregullorja e Universitetit, si dhe Kodi i Procedurave Administrative, pasi nuk është ndjekur procedura disiplinore nëpërmjet Këshillit të Etikës, nuk i është garantuar e drejta për t’u njoftuar me shkrim dhe nuk i është dhënë mundësia për t’u dëgjuar. Gjithashtu, ankuesja pretendon se brenda 24 orëve nga shkarkimi, pa respektuar asnjë afat ankimimi, me urdhërin nr.172 datë 06.11.2025, në detyrën e saj u emërua përkohësisht një person tjetër.

Pas shkarkimit, ankuesja parashtron se iu drejtua Ministrisë së Arsimit, e cila me shkresën nr. 7160/1 prot., datë 14.01.2026 konfirmoi se çështjet e etikës duhet t’i referohen Këshillit të Etikës. Pavarësisht kësaj, kërkesa e saj për revokimin e urdhërit nr. 168, paraqitur me shkresën nr. 110 prot., datë 21.01.2026, nuk mori përgjigje.

Ankuesja parashtron se sa i takon konfliktit me Dekanin e Fakultetit Ekonomik, në datën 11.11.2025, i është drejtuar Këshillit të Etikës, ku ka raportuar se i është cenuar liria akademike, integriteti dhe dinjiteti profesional. Në datën 11.02.2026, ankuesja deklaroi se i është komunikuar nga Këshilli i Etikës, vendimi në lidhje me ankimin e saj, ku nuk janë konstatuar shkelje. Ankuesja pretendon se gjatë procedurës së zhvilluar nga Këshilli i Etikës i është cenuar e drejta për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, dhe se ky vendim është i pavlefshëm edhe për faktin se kryetarja e Këshillit të Etikës ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit.

Më datë 12.02.2026, ankuesja ka depozituar kërkesë-padi në gjykatë për shfuqizimin e urdhërit të shkarkimit, e cila është në pritje për shqyrtim nga gjykata.

Ankuesja pretendon se pas ndërmarrjes së këtyre veprimeve ligjore, institucioni intensifikoi sjelljen e tij. Ankuesja pretendon se, Dekani i Fakultetit Ekonomik i drejtoi Këshillit të Etikës një ankesë të re kundër saj, pa e njoftuar zyrtarisht, duke kërkuar paralajmërim për largim nga puna. Në këtë pikë ankuesja thekson shprehimisht se ende nuk i është vënë zyrtarisht në dijeni kjo shkresë, edhe pse është palë e përfshirë.

Gjithashtu, në mbledhjen e Senatit Akademik të datës 25.03.2026, ankuesja pretendon se është hequr pa arsye dhe pa njoftim paraprak nga Bordi Editorial i Buletinit Shkencor “Kërkime Universitare”, në kundërshtim me Rregulloren e Buletinit Shkencor.

Ankuesja pretendon se, ka paraqitur kërkesë për integrimin e një lënde të re në kuadër të projektit ndërkombëtar READ, protokolluar pranë Universitetit më datë 10.03.2026, kërkesë për të cilën nuk ka marrë një përgjigje zyrtare, pavarësisht komunikimeve të vazhdueshme dhe pranisë së profesorit të diasporës në Universitet gjatë periudhës 14-24 prill 2026.

Bazuar në sa më sipër, ankuesja kërkon nga Komisioneri mbrojtjen nga vazhdimi i hakmarrjes dhe procedurave të nisura pa dijëni të saj, shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Etikës nr. 168/1 prot. datë 09.02.2026, si dhe rikthimin e saj në Bordin Editorial të Buletinit Shkencor.

II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri për shqyrtimin e ankesës

Në kuadër të shqyrtimit paraprak, Komisioneri konstatoi se, ankesa kishte mangësi të anës formale dhe në këtë kuadër me e-mailin e datës 14.05.2026 kërkoi nga pala ankuese plotësimin dhe saktësimin e ankesës në lidhje me veprimet dhe mosveprimet konkrete diskriminuese dhe lidhja e tyre me shkakun e pretenduar të diskriminimit në kuadër të përcaktimit "*çdo shkak tjetër*"/hakmarrje për shkak të ankesës së paraqitur pranë Ministrisë së Arsimit dhe depozitimit të kërkesë padisë në gjykatë.

Në përgjigje të kërkesës për plotësimin e ankesës, pala ankuese ka depozituar parashtrimet e saj plotësuese, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të pajisur me prokurë të përgjithshme nr. 296 rep, nr.108 kol, datë 12.05.2026, Studio Ligjore "Panajoti Law Group", përfaqësuar nga administratorja Avokate R. P, me nr.liçense 11077, të cilat janë administruar pranë Komisionerit me nr.847/1 prot., datë 18.05.2026. Në këto parashtrime plotësuese, pala ankuese parashtron ndër të tjera se:

Sjellja diskriminuese e institucionit ka nisur përpara shkarkimit nga pozicioni i drejtueses së njësisë bazë, duke u reflektuar gjatë gjithë procedurës për nxjerrjen e urdhërit nr. 168, datë 05.11.2025, të Rektorit të Universitetit. Theksohet se ankuesja, me mbi 10 vite eksperiencë, me titull shkencor dhe me statusin e gruas dhe nënës familjare, u shkarkua pa iu dhënë e drejta për t'u dëgjuar dhe pa u vlerësuar kualifikimi i saj, duke ngritur shprehimisht si shkaqe diskriminimi gjininë dhe gjendjen familjare të ankuses.

Urdhëri nr. 168, datë 05.11.2025, i Rektorit, është i paarsyetuar, pasi nuk bazohet në fakte apo prova konkrete, dhe nuk ka ndjekur procedurën e parashikuar ligjore, duke evidentuar se Ministria e Arsimit me shkresën nr. 7160/1 prot., datë 14.01.2026, ka konfirmuar detyrimin e referimit të çështjeve të etikës pranë Këshillit të Etikës.

Pretendohet se, diskriminimi ka vijuar edhe pas shkarkimit, pasi ankuesja u detyrua t'i drejtohet gjykatës administrative dhe, në vend të çdo reflektimi nga punëdhënësi, ai ka intensifikuar sjelljen armiqësore, duke i mohuar çdo të drejtë apo kërkesë ligjore që lidhet me ushtrimin e detyrës.

Pala ankuese rikonfirmon pretendimin për heqjen nga Bordi Editorial në datën 25.03.2026 dhe moskthimin e një përgjigje për kërkesën për integrimin e një lënde të re në kuadër të projektit ndërkombëtar READ. Ankuesja pretendon se, tërësia e këtyre veprimeve ka sjellë krijimin e një mjedisi pune armiqësor, frikësues dhe përçmues, në kuptim të nenit 3 pika 5 të Ligjit nr. 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar.

Përfundimisht pala ankuese, kërkon nga Komisioneri pranimin e ankesës dhe konstatimin e diskriminimit nga ana e institucionit punëdhënës, Universitetit “Eqrem Çabej”, titullarëve të këtij institucioni në të gjithë procedurën e ndjekur dhe urdhrin nr. 168 datë 05.11.2025, të Rektorit të Universitetit, nëpërmjet të cilit ankuesja është shkarkuar në kundërshtim me ligjin nga detyra e Përgjegjëses së Njësisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit.

- *Vlerësimi i Komisionerit*

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përliqjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (*Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përliqjes së arsyeshme dhe objektive. (*Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese*). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (*Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese*).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe sesa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁴.

⁴ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁵. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, diskriminimi i drejtpërdrejtë, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “*dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme*” dhe “*bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm*”⁶

Ligji Nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë të hapur shkaqesh, duke sanksionuar në nenin 1, të tij se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar (LMD), diskriminimi përcaktohet si : “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*”

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji. Për të pasur një pretendim për diskriminim, duhet domosdoshmërisht që të identifikohet një shkak, i cili në bazë të ligjit është i ndaluar ose i mbrojtur. Shkakut i diskriminimit përbën një nga elementët thelbësor për të paraqitur një pretendim për diskriminim.

⁵ Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019.

⁶ Shih: *Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe, datë 14.05.2016, § 89, Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Dhoma e Madhe 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.

Si rregull, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se, shkakun e pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak. Megjithatë, vetëm identifikimi i një ose më shumë shkaqeve, të cilat mbrohen në mënyrë të shprehur nga ligji, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për një ose më shumë se një, nga shkaqet e mbrojtura, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun ose shkaqet e mbrojtur/a.

- *Pretendimi për diskriminim në lidhje me urdhrin nr. 168, datë 05.11.2025, të Rektorit të Universitetit Eqerem Çabej Gjirokastër, për shkarkimin e ankuses nga pozicioni si Drejtuese e Njesisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit, Fakulteti Ekonomik.*

Nga aktet e administruara rezulton se, me urdhrin nr.168, datë 05.11.2025, të Rektorit të Universitetit “Eqerem Çabej”, ankuesja Prof.Asos I.B, me detyrë “Përgjegjëse e Njesisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit”, në Fakultetin Ekonomik, shkarkohet nga kjo detyrë, për shkak të sjelljes së papërshtatshme në marrëdhënie pune dhe shkeljes së rregullave institucionale, në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.80/2015 dhe Rregulloren e Brendshme të Universitetit. Kjo vendimarrje e Rektorit është bazuar në kërkesën e Dekanit të Fakultetit Ekonomik nr.167 prot., datë 22.10.2025.

Me urdhrin nr.172, datë 06.11.2025, të Rektorit të Universitetit Eqerem Çabej, në detyrën “Përgjegjëse e Njesisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit”, në Fakultetin Ekonomik është emëruar përkohësisht deri në zgjedhjen e përfaqësuesit të ri, pedagoge D.Q.

Ankuesja pretendon se urdhri nr. 168, datë 05.11.2025, i Rektorit, nëpërmjet të cilit është larguar nga detyra e Drejtueses së Njesisë Bazë, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë dhe gjendjes familjare, për faktin se ankuesja është grua dhe nënë familjare.

Komisioneri vëren se gjinia dhe gjendja familjare janë shkaqe të mbrojtura shprehimisht nga neni 1 i LMD. Megjithatë, vetëm për faktin se pala ankuese është grua, nënë, familjare, kjo nuk do të thotë se pretendimet e paraqitura ndaj urdhrin nr. 168, datë 05.11.2025, të Rektorit, janë pretendime për diskriminim. Për të patur një pretendim për diskriminim, duhet të ekzistojë lidhja shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pretenduar si të pafavorshëm. Kjo do të thotë se, gjinia ose gjendja familjare, duhet të kenë shërbyer drejtpërdrejt ose tërthorazi, si shkak ose motiv i vendimmarrjes së subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.

Nga shqyrtimi i ankesës dhe i materialeve të depozituara, Komisioneri konstaton se pala ankuese nuk ka paraqitur asnjë fakt, rrethanë apo indicie nga të cilat të rezultojë, madje as *prima facie*, se gjinia apo statusi i saj si grua dhe nënë familjare, ka shërbyer si shkak apo motiv i procedurës disiplinore ose i largimit nga detyra. Konkretisht:

Së pari, procedura disiplinore ndaj ankuses ka filluar bazuar në propozimin e Dekanit të Fakultetit Ekonomik, me shkresën nr. 167 prot., datë 22.10.2025, duke u bazuar në pretendime për shkeljen

e rregullave të etikës. Urdhri nr. 168, datë 05.11.2025, i Rektorit apo aktet e tjera të dala gjatë procedurës, nuk përmbajnë asnjë elementë ose referencë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndaj gjinisë së ankuseses ose statusit të saj familjar.

Së dyti, ankuesja nuk parashtron asnjë fakt krahasimor, qoftë edhe indirekt, i cili të tregojë se kolegë të gjinisë mashkullore ose persona që nuk kanë përgjegjësi familjare, që ndodheshin në situata të njëjta ose të ngjashme, u trajtuan në mënyrë më të favorshme ose se procedura disiplinore ndaj saj, nuk do të kishte filluar nëse ankuesja do të kishte gjini tjetër apo nuk do të kishte status familjar si nënë.

Komisioneri thekson se, mbrojtja nga diskriminimi nuk mund të zbatohet si instrument i përgjithshëm i kundërshtimit ndaj çdo vendimi institucional me të cilin personi nuk dakordësohet, qoftë edhe kur vendimi mund të çojë në kundërshtim me ligjin. Komisioneri është kompetent për të hetuar nëse një trajtim i pafavorshëm ka si bazë një shkak të mbrojtur, ndërkohë që verifikimi i ligjshmërisë së urdhrit nr. 168, i takon gjykatës, pranë të cilës ankuesja ka depozituar kërkesë-padi. Një sjellje diskriminuese është në çdo rast një sjellje e paligjshme, por jo çdo paligjshmëri përbën diskriminim.

Parashtrimet plotësuese të palës ankuese nuk sjellin fakte apo prova të reja lidhur me gjininë ose gjendjen familjare, si shkaqe diskriminimi. Ato shtojnë detaje mbi rrethanat faktike të largimit të ankuseses nga pozicioni si drejtuese e njësisë bazë dhe mbi procedurën e pretenduar si të paligjshme, pa sjellë asnjë element që të provojë lidhjen shkakësore ndërmjet gjinisë/gjendjes familjare dhe procedurës për nxjerrjen e vendimit nr.168, datë 05.11.2025 të Rektorit. Theksimi nga ana e ankuseses i statusit si "grua dhe nënë familjare me mbi 10 vite eksperiencë" nuk përbën, në vetvete, provë *prima facie* të diskriminimit, nëse nuk shoqërohet me elementë faktikë që sugjerojnë ose japin indicie minimale, se pikërisht këto karakteristika kanë motivuar trajtimin e padrejtë të pretenduar.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pretendimet e ankuseses lidhur me diskriminimin për shkak të gjinisë dhe gjendjes familjare në kuadër të urdhrit nr. 168, datë 05.11.2025, të Rektorit, janë haptazi të pabazuara, pasi nuk ekziston asnjë fakt, rrethanë apo indicie, nga të cilat të rezultojë lidhja shkakësore ndërmjet këtyre shkaqeve të mbrojtura dhe vendimmarrjes së subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa/Universitetit "Eqerem Çabej".

- *Pretendimi për diskriminim në lidhje me heqjen nga Bordi Editorial, në mbledhjen e Senatit Akademik të datës 25.03.2026*

Rezulton se, me vendimin nr.12, datë 25.03.2026 "*Për miratimin e përbërjes së Bordit Editorial të Buletinit Shkencor "Kërkime Universitare" në Universitetin Eqerem Çabej*", Senati Akademik ka vendosur: "*1. Të miratojë përbërjen e Bordit Editorial të Buletinit Shkencor "Kërkime Universitare"....*" Referuar këtij vendimi, konstatohet se ankuesja nuk figuron anëtare e Bordit Editorial. Në total, Bordi Editorial, i miratuar me anë të vendimit të Senatit Akademik të datës 23.03.2026, ka 15 anëtarë, Rektori është në pozicionin e kryetarit, ndërsa nuk rezulton të jetë anëtar Dekani i Fakultetit Ekonomik.

Komisioneri vëren se ankuesja nuk ka paraqitur asnjë provë nga e cila të rezultojë se ka qenë anëtare e Bordit Editorial para vendimit nr. 12, datë 25.03.2026. Ky fakt, në vetvete, bën të pamundur ngritjen e pretendimit për “heqje” nga bordi. Edhe nëse ankuesja pretendon se ka kërkuar kopjen e aktit të mëparshëm por nuk ka marrë përgjigje, kjo rrethanë nuk mund të kompensojë mungesën e provës, pasi ankuesja nuk ka depozituar pranë Komisionerit kërkesën për kopje ose ndonjë provë tjetër indirekte, si procesverbale të mbledhjeve ose korrespondencë, nga të cilat të rezultonte anëtarësia e saj e mëparshme.

Nga shqyrtimi i ankesës dhe i parashtrimeve plotësuese të paraqitura nga pala ankuese, Komisioneri konstaton se, pala ankuese pretendon se heqja e saj nga Bordi Editorial i Buletinit Shkencor, gjatë mbledhjes së Senatit Akademik të datës 25.03.2026, përbën trajtim të padrejtë dhe të disfavorshëm si pasojë e “ankesës së paraqitur pranë Ministrisë së Arsimit” dhe “kërkesë-padisë të depozituar në gjykatë kundër urdhrit të Rektorit”.

Komisioneri, vëren se, shkak i pretenduar nga pala ankuese si shkak diskriminimi “*ndërmarrja e veprimeve ligjore për mbrojtjen e të drejtave të saj*”, nëpërmjet “*ankesës së paraqitur pranë Ministrisë së Arsimit*” dhe “*kërkesë-padisë së depozituar në gjykatë kundër urdhrit të Rektorit*”, nuk parashikohet shprehimisht si shkak i mbrojtur nga neni 1, i LMD.

Neni 1, i LMD, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është e mbyllur por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes për “*çdo shkak tjetër*”. Thënë kjo, nuk presupozon se, termi “*çdo shkak tjetër*” përbën një shkak në vetvete. Rregullimi i bërë nga neni 1, i LMD-së nëpërmjet termit “*çdo shkak tjetër*” mundëson mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe të tjera, përveç shkaqeve të listuara shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit, por duke identifikuar “*shkakun*” i cili pretendohet se gëzon mbrojtje në kuadër të termit “*çdo shkak tjetër*”.

LMD, por edhe legjislacioni ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, nuk ka parashikime ose përkufizim se çfarë është shkak i mbrojtur. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një *karakteristikë personale të identifikueshme, objektive ose personale, ose "status", me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.*⁷

Nga aktet e administruara rezulton se, me shkresën nr.7160/1 prot, datë 14.01.2026, me lëndë “*Kthim përgjigje*”, Ministria e Arsimit, i është drejtuar Universitetit “Eqerem Çabej” me sqarimet përkatëse, në lidhje me procedurën e lirimimit të ankueses nga detyra e drejtueses së Njesisë Bazë, duke sqaruar se, rastet e shkeljes së Kodit të Etikës i paraqiten Këshillit të Etikës, i cili merr vendime me shumicë të thjeshtë dhe ia dërgon për miratim Rektorit.

Në vijim të shkresës së Ministrisë së Arsimit, ankuesja me shkresën nr.110 prot., datë 21.01.2026, ka kërkuar revokimin e urdhrit nr.168, datë 05.11.2025, të Rektorit. Nga aktet e administruara nuk rezulton që ankuesja të ketë marrë një përgjigje në lidhje me këtë kërkesë.

⁷ Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70; *Novruk dhe të Tjerët kundër Rusisë*, prg. 90.

Në këto kushte, rezulton se, në datën 12.02.2026, ankuesja ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë për kundërshtimin e të dy urdhrave të Rektorit, nr.168, datë 05.11.2025 dhe nr.172, datë 06.11.2025.

Komisioneri vëren se, edhe nëse do të supozohej se veprimet ligjore të ndërmarra nga ankuesja mund të konsiderohen si shkak i mbrojtur në kuadër të “çdo shkak tjetër” në kuptim të nenit 1 të LMD, pala ankuese duhet të sjellë fakte ose indicie nga të cilat të rezultojë, të paktën *prima facie*, se Senati Akademik, si organ vendimmarrës, ka ndërmarrë këtë veprim me qëllim ndëshkimin e ankuseses për veprimet e saj ligjore. Ndërsa rendi kronologjik i ngjarje ka rëndësi, bazuar në faktet dhe rrethanat konkrete të çështjes, kjo lidhje shkakësore nuk mund të prezumohet vetëm nga rendi kronologjik i ngjarjeve.

Në këtë kuadër, Komisioneri vëren se, bazuar në nenin 37, të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Senati Akademik i Universitetit, funksionon si organ kolegjal. Sipas pikës 2, të nenit 37, të ligjit të sipërcituar, Senati kryesohet nga Rektori, ndërsa referuar pikës 3, të po kësaj dispozite, anëtarët e Senatit Akademik të institucioneve të arsimit të lartë zgjidhen nga asambltetë e personelit akademik të njëjësive kryesore, përmes një votimi të përgjithshëm, për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar. Anëtarët e senatit në institucionet e arsimit të lartë i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), në mungesë të autoriteteve drejtuese me këtë titull dhe, për efekt të përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbresë, sipas përcaktimeve të bëra në statutin e institucionit. Në Senatit Akademik përfaqësohen edhe studentët në institucionet publike, në masën dhjetë për qind (pika 4, e nenit 37, të ligjit nr.80/2015).

Referuar Rregullores së Brendshme të Senatit Akademik, miratuar me vendimin nr.44, datë 3.9.2024, të Senatit Akademik të Universitetit “Eqerem Çabej”, vendimet e Senatit Akademik merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, përvec rasteve kur parashikohet ndryshe (neni 19, i Rregullores së Brendshme).

Rektori, i cili është Kryetar i Senatit Akademik, nuk luan rol thelbësor individual në vendimarrjet e Senatit Akademik dhe vendimet janë produkt i vullnetit të shumicës së organit kolegjal. Rrjedhimisht, edhe nëse Rektori individualisht, në cilësinë e anëtarit ose kryetarit të Senatit Akademik, do të kishte ndonjë interes personal lidhur me ankesën apo padinë e depozituar ndaj tij, ky motiv individual nuk mund t’i atribuohet automatikisht Senatit Akademik, si organ kolegjal. Anëtarët e tjerë të Senatit Akademik janë subjekte të pavarura vendimmarrëse, ndaj të cilëve nuk mund të prezumohet bashkëpjesëmarrje në hakmarrje vetëm për shkak të bashkëanëtarësisë në të njëjtin organ.

Nga dokumentacioni i depozituar nga pala ankuese, nuk rezulton asnjë provë apo indicie konkrete nga e cila të mund të konstatohet ose prezumohet se Senati Akademik, si organ kolegjal, ka vlerësuar ankesën ndaj Rektorit ose kërkesë-padinë e paraqitur nga ankuesja në gjykatë, si rrethanë relevante për vendimarrjen, ose se heqja nga Bordi Editorial, ka pasur si qëllim ndëshkimin e ankuseses.

Nuk ka asnjë provë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë që të tregojë ndonjë qëllim hakmarrës të Senatit Akademik ndaj ankueses për shkakun e pretenduar prej saj. Kronologjia e ngjarjeve, edhe nëse tregon se heqja nga Bordi Editorial ka pasuar depozitimimin e ankesës në Ministrinë e Arsimit dhe padisë në gjykatë, nuk është e mjaftueshme, në vetvete, për të provuar lidhjen shkakësore të kërkuar.

Komisioneri vëren gjithashtu se ankuesja nuk ka paraqitur asnjë shpjegim lidhur me procesin vendimmarrës të Senatit Akademik për këtë çështje apo nëse ka pasur ndonjë ndryshim të përgjithshëm në përbërjen e Bordit Editorial apo ndryshimi i vetëm ka qenë largimi i saj.

Për sa më sipër, Komisioneri konstaton se pretendimet e ankueses lidhur me heqjen nga Bordi Editorial janë haptazi të pabazuara, pasi mungojnë fakte, rrethana apo indicie që të provojnë qëllimin hakmarrës të Senatit Akademik si organ kolegjal dhe lidhjen e tij me veprimet ligjore të ndërmarra nga ankuesja.

- *Pretendimi për diskriminim lidhur me moskthimin e përgjigjes ndaj kërkesës së datës 10.03.2026 për integrimin e lëndës së re.*

Rezulton se në datën 10.03.2026, ankuesja i është drejtuar përgjegjëses së Njesisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit, me një kërkesë për integrimin e një lënde të re “*Sociologji-Antropologji Turizmi*” në programet mësimore që ofrohen nga kjo njësi bazë.

Nëpërmjet *e-mailit* të datës 30.03.2026, ankuesja i është drejtuar sërish drejtueses së Njesisë Bazë, duke theksuar se nuk ka marrë një përgjigje për kërkesën e saj.

Nëpërmjet një tjetër *e-maili* në datën 09.04.2026, ankuesja i ka përcjellë drejtueses së Njesisë Bazë një material në lidhje me lëndën e re të propozuar, në vijim të një diskutimi të zhvilluar në mbledhjen e departamentit të datës 30.03.2026.

Ankuesja pretendon se moskthimi i përgjigjes ndaj kërkesës së datës 10.03.2026, për integrimin e lëndës së re “*Sociologji-Antropologji Turizmi*” në kuadër të projektit ndërkombëtar READ, përbën diskriminimi për shkak të “ankesë së paraqitur në Ministrinë e Arsimit” dhe “kërkesë-padisë së depozituar në gjykatë”.

Komisioneri vlerëson se edhe ky pretendim është haptazi i pabazuar. Mosmarrja e përgjigjes ndaj një kërkesë administrative, brenda periudhës kohore midis, nga njëra anë, paraqitjes së kësaj kërkesë (datë 10.03.2026) dhe nga ana tjetër, paraqitjes së ankesës pranë Komisionerit (datë 30.04.2026, nuk përbën në vetvete një sjellje diskriminuese sipas LMD. LMD nuk është instrument ligjor për trajtimin e heshtjes administrative ose mospërbushjes së detyrimeve procedurale nga institucionet.

Moskthimi i përgjigjes ndaj një kërkesë mund të ketë shpjegime të shumta, si procedurat e brendshme, shpërndarja e kompetencave ndërmjet njësive organizative ose afate ligjore të përgjigjes në lidhje me procedurat e parashikuara për integrimin e një lëndë të re. Ankuesja nuk ofron asnjë element nga i cili të rezultojë se, moskthimi i kësaj përgjigjeje i ka shkaktuar një trajtim të ndryshëm ose të pafavorshëm ose se subjekte të tjera në situata të ngjashme, do të kishin marrë

përgjigje. Fakti që nuk ka marrë përgjigje nuk tregon në vetvete asnjë element konkret të cenimit të ankueses. Për më tepër, nga kërkesa e datës 10.03.2026 që ankuesja ka depozituar si dhe komunikimet e zhvilluara, rezulton se, lënda e re e propozuar për tu integruar në programet mësimore, është parashikuar në kuadër të një projekti, që drejtohet nga ankuesja, por ka në përbërje edhe dy pedagogë të tjerë, njëri prej të cilëve nga diaspora.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se edhe ky pretendim është haptazi i pabazuar.

- *Në lidhje me vendimin nr.168/1 prot., datë 09.02.2026, të Këshillit të Etikës, i cili ka disponuar mbi ankesën e datës 11.11.2025 të paraqitur nga ankuesja*

Rezulton se në datën 11.11.2025, ankuesja i është drejtuar Këshillit të Etikës me një ankesë duke pretenduar se i është cenuar liria akademike, integriteti dhe dinjiteti profesional. Ankuesja ndër të tjera, ngre pretendime për shkelje të procedurës ligjore të shkarkimit duke kundërshtuar urdhrin e datës 05.11.2025 të Rektorit, pretendime ndaj Dekanit të Fakultetit Ekonomik lidhur me komunikimin dhe mbarëvajtjen e punës, pretendime për ekzistencën e një mase disiplinore ndaj saj. Ankuesja ka paraqitur edhe pretendime për konflikt interesi, të cilat rezultojnë që janë shqyrtuar dhe janë vlerësuar të pabazuara. Ky vlerësim i është komunikuar ankueses, e cila ka paraqitur kundërshtimet e saj.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga ankuesja, Këshilli i Etikës me vendimin nr.168/1 prot datë 9.2.2026, ka arritur në konkluzionin se nuk rezultojnë elementë të provuar që përbëjnë shkelje të normave të etikës profesionale dhe se pretendimet e paraqitura lidhen kryesisht me marrëdhënie pune dhe çështje të organizimit administrativ. Vendimi i Këshillit të Etikës është miratuar nga Rektori me vendimin nr. 3, datë 11.02.2026. Kjo vendimarrje i është komunikuar ankueses me shkresën nr.238 prot., datë 11.02.2026, të Këshillit të Etikës.

Në parashtrimet e saj plotësuese, pala ankuese nuk ka paraqitur sqarime ose pretendime konkrete për diskriminimin në lidhje me vendimarrjen e Këshillit të Etikës së datës 09.02.2026, përveç pretendimeve për shkelje të procedurës ligjore dhe konfliktit të interesit.

Gjithashtu, nga aktet e administruara nuk rezulton asnjë fakt dhe provë në lidhje me pretendimin e ankueses së, Dekani i Fakultetit Ekonomik i është drejtuar Këshillit të Etikës me një ankesë të re kundër saj, duke kërkuar paralajmërim për largim nga puna.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “ç” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;”, Komisioneri vlerëson se ankesa objekt shqyrtimi nuk duhet të pranohet, pasi është haptazi e pabazuar. Në kushtet kur ankesa nuk përmbush kriteret ligjore, ajo nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Konstatimi se ankesa është haptazi e pabazuar sipas LMD-së nënkupton vetëm se pretendimet e parashtruara nuk plotësojnë kriteret ligjore të nevojshme për ngritjen e një pretendimi për

diskriminim, konkretisht, mungesën e lidhjes shkakësore ndërmjet trajtimit të pretenduar si të pafavorshëm dhe shkaqeve të mbrojtura nga ligji. Ky konstatim nuk përbën dhe nuk duhet interpretuar si vlerësim i Komisionerit mbi bazueshmërinë e pretendimeve të ankueses jashtë fushës së LMD-së, as si mohim i faktit se ankuesja mund të ketë të drejta të cenuara në kuadër të legjislacionit të punës, të arsimit të lartë apo të procedurave administrative. Çështja e ligjshmërisë së urdhrit nr. 168, datë 05.11.2025, të Rektorit, po shqyrtohet nga gjykata pranë së cilës ankuesja ka depozituar tashmë kërkesë-padi, ndërsa çdo pretendim tjetër lidhur me të drejtat e punës, procedurat disiplinore, konfliktin e interesit apo të drejtën e informimit, mund të adresohet para institucioneve të tjera përgjegjëse.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “ç” të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr.112 Regj., datë 30.04.2026, të paraqitur nga znj. I.B kundër Universitetit “Eqerem Çabej”, për shkaqet e pretenduara të diskriminimit, për arsye se nuk përmbushen kushtet ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Genta Tafa (BUNGO)

Shkaku: Gjinia, gjendja familjare , “çdo shkak tjetër”⁸
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mospranim

⁸ “hakmarrja për shkak të ankesës që ankuesja ka bërë në Ministrinë e Arsimit dhe padia e paraqitur në gjykatë”